

DEKLARATË PËR PARIMET E INVESTIMIT

FONDI I PENSIONIT PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR

RAIFFEISEN

V1.0

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI I DEKLARATËS
2. OBJEKTIVAT E INVESTIMIT
3. STRATEGJIA E INVESTIMIT DHE SHPËRNDARJA E AKTIVEVE
4. PROCESI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT
5. METODAT E VLERËSIMIT TË RREZIKUT NGA INVESTIMI
6. PROFILI I RREZIKUT TË FONDIT DHE TOLERANCA
7. QEVERISJA DHE ZBATIMI
8. PUBLIKIMI DHE RISHIKIMI I DEKLARATËS

1. Qëllimi i Deklaratës

Deklarata për parimet e investimit përcakton parimet bazë mbi investimet e aktiveve të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen (në vijim Fondi) dhe qëllimi i saj është të garantojë një qasje transparente, të matur dhe afatgjatë ndaj menaxhimit të aktiveve të fondit.

Deklarata për parimet e investimit për Fondin e Pensionit Privat Raiffeisen me pjesëmarrje të hapur është përgatitur nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest sh.a, në përputhje me nenin 92, të Ligjit Nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe nenin 34 të Rregullores Nr. 154 datë 19.09.2024 “Mbi rregulla të mëtejshme për investimet dhe veprimtarinë e fondit të pensionit privat”.

2. Objektivat e investimit

Objektivi i investimit të Fondit të Pensionit është optimizimi i përfitueshmërisë në terma afatgjatë duke synuar sigurinë e investimit dhe minimizimin e rrezikut, me qëllimin për të siguruar të ardhura të mjaftueshme gjatë periudhës së pensionit.

Objektivat specifikë janë:

Siguria: Fokus tek ruajtja e principalit;

Likuiditeti: Përbushja e detyrimeve ndaj anëtarëve;

Kthimi nga investimi: Maksimizim i kthimeve nga investimi brenda kufijve të rrezikut të pranueshëm.

3. Strategjia e investimit dhe shpërndarja e aktiveve

Fondi ndjek një strategji konservatore, të orientuar drejt investimeve në tituj borxhi të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i sigurimit të të ardhurave të mjaftueshme në moshën e pensionit arrihet nëpërmjet diversifikimit të portofolit sipas maturiteve dhe menaxhimit të kujdesshëm të likuiditetit, duke ruajtur një raport optimal kthim/rrezik. Horizonti i rekomanduar i investimit është afatgjatë, deri në moshën e pensionit.

Strategjia e investimit bazohet në një analizë të gjerë të tregut dhe përfshin:

- Strukturë konservative të portofolit të titujve, e përbërë kryesisht nga instrumente borxhi të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
- Përzgjedhje e llojit të obligacioneve, duke u bazuar në pritshmërinë mbi normën dhe kohëzgjatjen.
- Mbajtjen e një pjese të aktiveve të fondit në instrumenta financiarë, që mund të konvertohen lehtësisht në likuiditet.

Shpërndarja e synuar e aktiveve:

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE		
Instrumenti	Shpërndarja e synuar e aktiveve*	Maksimum
Tituj të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	95%	100%
Tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara në Republikën e Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar.	0%	30%
Depozita bankare, marrëveshje të anasjellta të riblerjes, cash dhe ekuivalentë cash-i	5%	100%
Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, të pranuar për tregtim në listën zyrtare në një treg të rregulluar në një vend të OECD-së.	0%	100%
Kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, me përjashtim të fondeve të investimeve alternative.	0%	30%

* Shpërndarja e synuar e aktiveve tregon se fokusi i investimit do të jetë në tituj borxhi të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Kufizimet e shpërndarjes paraqesin kufij të sipërm, mbi të cilët Shoqëria Administruese nuk do të kryejë investime në një kategori të caktuar aktivesh .

4. Procesi i administrimit të rrezikut

Raiffeisen Invest sh.a ka një strukturë të mirëorganizuar dhe me një ndarje të qartë të njësive së Investimeve (Front Office) nga njësia e Administrimit të rrezikut (Middle Office) si edhe nga njësia e Operacioneve (Back Office). Kjo ndarje funksionale dhe hierarkike e funksionit të administrimit të rrezikut lejon kryerjen e pavarur të aktiviteteve të administrimit të rrezikut dhe ofron mbrojtje kundër konflikteve të interesit.

Njësia e administrimit të rrezikut është përgjegjëse për evidentimin e rreziqeve, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, si dhe ofrimin e udhëzimeve strategjike për shoqërinë për t'i zbutur ato. Veprimtaria e kësaj njësie udhëhiqet nga Politika e Administrimit të Rrezikut.

Sistemi i administrimit të rrezikut përmban:

- ✓ Politikën dhe procedurat e administrimit të rrezikut;
- ✓ Metodën apo teknikat e vlerësimit të rrezikut;
- ✓ Monitorimin dhe raportimin e rrezikut

5. Metodat e vlerësimit të rrezikut nga investimi

Shoqëria ka përcaktuar në politikat dhe procedurat e brendshme metodat e matjes, monitorimit dhe raportimit të treguesve kryesorë të rrezikut.

Në vijim detajohen rreziqet kryesore ndaj të cilave ekspozohet Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur Raiffeisen si dhe metodat e vlerësimit të tyre.

Rreziku	Shkalla e Ndikimit	Metodat e vlerësimit
Rreziku i tregut	E moderuar	Monitorimi i vazhdueshëm i tregjeve dhe analizimi i ndikimit të ndryshimeve makroekonomike në kthimet reale të investimeve.
Rreziku i normës së interesit	E ulët	Shumica e obligacioneve vlerësohen si aktive të mbajtura deri në maturim (HTM). Menaxhimi i Kohëgjatjes (Duration) të portofolit, përdoret për obligacionet që vlerësohen si të vlefshëm për shitje (AFS)
Rreziku i kredisë	E ulët	Analiza e qëndrueshmërisë financiare të Qeverisë së RSH dhe monitorimi i vlerësimeve të kreditit.
Rreziku Operacional	E ulët – E moderuar	- Vlerësimin e Risqeve - Treguesit e paralajmërimit të hershëm - Analizat bazuar në skenarë - Mbledhja e të dhënave lidhur me ngjarjet e rrezikut operacional.
Rreziku i Likuiditetit	E moderuar	Analiza e nevojave për likuiditet dhe mbajtja e një niveli të përshtatshëm likuiditeti.
Rreziku Ligjor	E ulët	Njësi e dedikuar për çështjet ligjore dhe përputhshmërisë, e cila siguron zbatimin rigoroz të kuadrit ligjor.
Rrezikui Agjencisë	E ulët	- Qeverisja e brendshme bazuar në struktura efektive si: Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Administrimit, Administratorët Ekzekutive dhe Komiteti i Investimeve - Struktura organizimit që siguron mirëndarje të detyrave - Transparenca me Anëtarët përmes raportimeve periodike - Politikat për Menaxhimin e Konfliktit të Interesit dhe Politikat e Ekzekutimit më të mirë

Rreziku reputacional	I moderuar	• Sigurimi i transparencës me investorët dhe publikun mbi performancën e fondeve dhe çështje të tjera që lidhen me to. • Vendosja e një mekanizimi efektiv për menaxhimin e ankesave dhe adresimin e tyre.
Rreziku i Përputhshmërisë	I ulët	• Njësi e dedikuar për përputhshmërinë, e cila kryen kontrole të vazhdueshme dhe raportime periodike.
Rreziku i Ndryshimit të Tatimit	I mesëm	• Monitorimi i legjislacionit tatimor dhe përshtatja me ndryshimet për të minimizuar ndikimin.

6. Profili i Rrezikut të fondit dhe Toleranca

Fondi ka një profil të ulët të rrezikut, i ndikuar nga natyra konservative e investimeve të tij. Investimet përqendrohen ekskluzivisht në tituj borxhi të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të vlerësuar kryesisht si aktive të mbajtura deri në maturim (HTM). Kjo qasje siguron stabilitet dhe besueshmëri në kthimet afatgjata, duke minimizuar ekspozimin ndaj luhatjeve të tregut financiar.

Si i tillë, fondi është i përshtatshëm për anëtarë me një tolerancë të ulët ndaj rrezikut, të orientuar drejt ruajtjes së kapitalit dhe kthimeve afatgjata të qëndrueshme.

7. Qeverisja dhe Zbatimi

Politika e investimit miratohet nga Komiteti i Investimeve. Monitorimi dhe raportimi bëhen rregullisht. Vendimmarrja dhe raportimi zbatohen në përputhje me rregullat e brendshme dhe kuadrin ligjor.

8. Publikimi dhe rishikimi i Deklaratës

Kjo Deklaratë do të publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë administruese në datë 09.05.2025. Ajo do të rishikohet të paktën çdo tre vjet, apo menjëherë nëse ka ndryshime të konsiderueshme në politikat e investimit në përputhje me kërkesat ligjore.